

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Gjyqtari që dënoi ish-krerët e UÇK-së ishte akuzuar për ndërhyrje në drejtësi gjatë kohës që shërbente në EULEX
ADRESA	https://lajmifundit.al/gjyqtari-qe-denoi-ish-kreret-e-uck-se-ishte-akuzuar-per-nderhyrje-ne-drejttesi-gjate-kohes-qe-sherbente-ne-eulex-i1338953
BURIMI	lajmifundit.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 07:55:01 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 09:48:21 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	92aece2b2cae5c3c34554c910ab7df1b9abcf460530ef7166f139bf82ba7658
TEKSTI	c0321ee24ca4aabaf20eaafefb690a8924d16ccfa58838de855a5d72db5e65071
PAMJA	689b755e3dcab5ea33e2d6fc4e7532ab9bb4468f0d8c5fd1e8029a3ad824813b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	49d81a9ecc94418ac8db757253be7e9dd1551d734cef3a86552dc0a96fcc8414
E MËPARSHMJA	—
RRËNJJA MERKLE	f736abde33fe298fdab4b0ac01389ddc82e49c4df4ee1e7f323305e5a671536d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/49d81a9ecc94418ac8db757253be7e9dd1551d734cef3a86552dc0a96fcc8414

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Gjyqtari që dënoi ish-krerët e UÇK-së ishte akuzuar për ndërhyrje në drejtësi gjatë kohës që shërbente në EULEX

[Lexo lajmin e plotë](#) →

Nafta Brent rritet mbi 3%, Trump refuzoi propozimin e Iranit për Ngushticën e Hormuzit

[Lexo lajmin e plotë](#) →

I ftoi në bisedime, Gjykata e Lartë dhe dy shoqatat e gjyqtarëve refuzojnë Ramën, ja deklarata

[Lexo lajmin e plotë](#) →

Skandal financiar me shuma të majme në Turqi, nënkryetarja e AKP-së jep dorëheqjen

[Lexo lajmin e plotë](#) →

Çfarë dihet deri më tani? Nën akuzë për abuzim ndaj të miturve, arrestohet 56-vjeçari shqiptar

[Lexo lajmin e plotë](#) →

Gjyqtari që dënoi ish-krerët e UÇK-së ishte akuzuar për ndërhyrje në drejtësi gjatë kohës që shërbente në EULEX



LAJMI FUNDIT / 28 SEPTEMBER 2026, 09:48

Shpërndaje

BOTA



Charles L. Smith III, gjyqtari amerikan që më 16 shtator kryesoi panelin e Gjykatës Speciale që dënoi Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Rexhep Selimin dhe Jakup Krasniqin, kishte qenë më herët pjesë e EULEX-it në Kosovë, periudhë gjatë së cilës ndaj tij u ngritën pretendime për ndërhyrje në procese gjyqësore.

Smith shërbeu si gjyqtar i EULEX-it nga viti 2010 deri më 2013 dhe gjatë kësaj kohe ishte edhe anëtar i Gjykatës Supreme të Kosovës. Në vitin 2013 ishte zgjedhur kryetar i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it.

Akuzat ndaj tij u bënë publike nga Malcolm Simmons, ish-kryetar i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, i cili pas largimit nga misioni akuzoi drejtues të tij për korrupsion, ndërhyrje politike dhe presion ndaj gjyqtarëve e prokurorëve.

Në vitin 2021, Insajderi publikoi dëshminë 110-pikëshe të Simmons, të cilën ai ia kishte dorëzuar kryeministrit Albin Kurti.

Një prej rasteve kryesore të përmendura nga Simmons ishte "Kleçka", ku Fatmir Limaj dhe persona të tjerë po gjykohehin për krime lufte. Sipas Simmons, EULEX-i kishte interes që Limaj të dënohej për shkak të rëndësisë politike që rasti kishte në raport me dialogun Kosovë-Serbi.

LEXONI GJITHASHTU



I ftoi në bisedime, Gjykata e Lartë dhe dy shoqatat e gjyqtarëve refuzojnë Ramën, ja deklarata

MOTI NE TIRANE

Tirana, Albania

POLITIKË

Protesta në diën e 120, qytetari: Vuajmë për bukën e gojës, Rama tallet

POLITIKË

"S'jam engjëll, ama...", Rama: Nuk ka bir nënë që gjen një qindarkë të tijën në xhepin tim!

TRENDING



Destinacioni sekret: Wizz Air sjell në TIA 150 influencers dhe gazetarë për të zbuluar Shqipërinë



Kryeministri Rama në New York: Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës, dëshmi e transformimit të Shqipërisë



Nafta Brent rritet mbi 3%, Trump refuzoi propozimin e Iranit për Ngushticën e Hormuzit



Skandal financiar me shuma të majme në Turqi, nënkryetarja e AKP-së jep dorëheqjen

Sipas dëshmisë së Simmonsit, Charles Smith, atëherë kryetar i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, i kishte dërguar një email më 29 janar të 2013-ës, ku kërkonte që çështja e Limajt të procedohej sa më shpejt, duke iu referuar “një numri arsyesh, shumica politike”. Simmons më tej pretendonte se, pasi ishte caktuar në panelin e rastit, Smith i kishte thënë se misioni “priste” dënime dhe se puna e tij mund të rrezikohej nëse të akuzuarit nuk dënoheshin.

“Kur u caktova në trup gjykues, më 2013 Charles Smith më informoi që misioni “varej shumë” nga rezultati i këtij rasti. Ai tha që misioni “priste dënime.” Madje ai tha që puna ime mund të rrezikohej nëse të pandehurit nuk dënoheshin. Gjyqtari Charles Smith tani është gjyqtar në Dhomat e Specializuara të Kosovës”.

Simons zbulon edhe raste tjera të ndërhyrjes së Charles Smith. Sipas pretendimeve të tij, Smith i kishte ndërhyrë edhe gjyqtarës Mariola Plasnik dhe gjyqtarit Viktor Pardal.

“Më 18 korrik 2013 Gjyqtarja Pasnik mori një email nga Charles Smith në të cilin Charles Smith u shfaq duke i dhënë udhëzime gjyqtarës Pasnik se si të procedonte çështjen për një lëndë në të cilën ajo ishte kryetare e trupit gjykues”, thotë ai.

“Unë isha gjithashtu i pranishëm në datat 11 dhe 15 korrik 2013 kur gjyqtarja Pasnik pranoi një thirrje telefonike nga Charles Smith me ç’rast ajo vuri bisedën në altoparlant gjatë së cilës Charles Smith, u përpoq të ndërhynte në të njëjtin rast duke sugjeruar që ajo të shqiptojë një dënim me burg. Këto biseda i shënova në një email gjatë kësaj kohe të drejtuar gjyqtarës Pasnik”, shkruante në padi Simons.

Ka përmendur ndërhyrjet që ishin bërë gjyqtarit tjetër Vitor Pardal. Vetë Pardal kishte treguar se si Charles Smith dhe zëvendësi i tij, Gerrit Sprenger, kishin provuar të ndërhyjnë në një nga lëndët e tij.

“Në të vërtetë, ai (Pardal v.j.) pretendonte se procedurat e mëposhme disiplinore që u ngritën kundër tij ishin rezultat i refuzimit të tij për të ndjekur udhëzimet e tyre në atë rast të veçantë”, shkruan në padi.

Për këtë rast të mosbindjes, Simons thotë se Charles Smith me t’u kthyer nga një udhëtim në Bruksel i kishte thënë se ishin diskutuar procedura disiplinore kundër Vitor Pardal.

“Ai (Smith v.j.) tha se i tha stafit të SHJBE (EEAS) në Bruksel se gjyqtari Pardal ‘duhej të shkonte’ dhe se ‘është puna ose ai ose unë’, pretendon Simons.

Këto ishin pretendime të Simmonsit, të cilat Insajderi i publikoi bazuar në dëshminë dhe dokumentet e tij. Në raportimet e atëhershme u përfshi edhe qëndrimi i EULEX-it se ndaj Simmonsit vetë ishin zhvilluar hetime për akuza serioze dhe se misioni kishte kërkuar prej tij prova për pretendimet e ngritura.

“Ne jemi në dijeni për zhvillimin e një procedure civile në Mbretërinë e Bashkuar në lidhje me çështje të punësimit. EULEX-i nuk është palë e asaj procedure. Megjithatë, gjykata është duke shqyrtuar nëse EULEX-i duhet të jetë palë në atë procedurë civile. Meqë Mbretëria e Bashkuar ka një rregull për rregullimin e publikimit të çështjeve që janë nën shqyrtimin e gjykatës, ne nuk mund të komentojmë më tutje”, thuhej në një përgjigje të zyrës për media të EULEX-it.

Simmons kishte thënë se Qeveria e Kosovës duhet të reagojë pasi tha se Gjykata Speciale “është aty vetëm për t’i ndëshkuar ish-komandantët e UÇK-së”. /Insajderi.org/

POLITIKË

“Korrupsioni nuk po shtohet, po goditet”, Rama: Hetimet e drejtësisë, si dëshmi e një kapitulli të ri

POLITIKË

Publikimi i mesazheve të Vlorë Hysenit me Ergys Agasin, Rama për SPAK e GJKKO: Nxorën në pazar sekretet hetimore

ME TE LEXUARAT

“Zbraz karika torin ndaj shqiptarëve që i hynë në shtëpi” – Mediat italiane: Jeta e “dyfishtë” e...
[Lexo lajmin e plotë](#)

Euron pëson rënien si asnjëherë më parë, me sa tregtohet sot, këmbimi valutor 23 shtator 2026
[Lexo lajmin e plotë](#)

Skandali “Xhaka” merr përmasa të tjera, mjekja del kundër kapitenit: E kam vaksinuar vetë
[Lexo lajmin e plotë](#)

Zbulohet e vërteta për Bleona Matën, avokati: E ëma në gjendje të rëndë! A ndodhet në Greqi?...
[Lexo lajmin e plotë](#)

ME TE LEXUARAT

“Zbrazti karika'torin ndaj shqiptarëve që i hynë në shtëpi” – Mediat italiane: Jeta e “dyfishtë” e Gjovalin Lazrit

[Lexo lajmin e plote](#)

NA SHKRUAJ

Portali Lajmifundit sjell Lajme nga Shqipëria, rajoni dhe bota në kohë rekord. Ju lutemi na kontaktoni nëse doni të kontribuoni me informacione të vlefshme për publikim në portalin tonë.

[Kliko për më shumë informacion](#)

Euron pëson rënien si asnjëherë më parë, me sa tregtohet sot, këmbimi valutor 23 shtator 2026

[Lexo lajmin e plote](#)

Skandali “Xhaka” merr përmasa të tjera, mjekja del kundër kapitenit: E kam vaksinuar vetë

[Lexo lajmin e plote](#)

Zbulohet e vërteta për Bleona Matën, avokati: E ëma në gjendje të rëndë! A ndodhet në Greqi?!

[Lexo lajmin e plote](#)

“Askush nuk është mbi ligjin”/ Rama shkarkon menjëherë Vlorë Hysenin: Pas kthimit në Tiranë zgjedh drejtuesin e ri të SHISH

[Lexo lajmin e plote](#)

Sekuestrohet hoteli “Central Park Premium” në Ksamil, u ndërtua pa leje! Ja kujt i përket

[Lexo lajmin e plote](#)

“Ka gjëra që edhe ne që i dimë nuk flasim dot”/ Artan Hoxha: Ka fakte tronditëse për Ballukun, gropa u hap

[Lexo lajmin e plote](#)

LAJMI FUNDIT   **KUSH JEMI** **KONTAKT REDAKSINË** **TE DHENAT PERSONALE** **COOKIES**

LajmiFundit merr pjesë në programe të ndryshme marketingu ku mund të përfitojë komisione për produktet e zgjedhura në artikujt e publikuar.

Created & Monetized by **Mediadesk**

REGJISTROHU NË NEWSLETTER

OK

Ju do të merrni njoftime periodike me Lajmet e Fundit.